



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija /
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

POLITIKA PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

në Institucionet e Arsimit Parauniversitar





Të dashur edukatorë, mësime dhënë dhe udhëheqës të institucioneve tona edukative e arsimore,

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka përgatitur një dokument tejet të vlefshëm për sistemin arsimor, i cili ravigëzon kornizat e punës të gjithë stafit arsimor në kontekstin e mbrojtjes së fëmijës, si detyrim ligjor dhe përgjegjësi institucionale.

E tillë është Politika për Mbrojtjen e Fëmijës, e cila vjen për ju në një format të lehtë dhe praktik, për përdorim në punën tuaj të përditshme.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, i harton politikat arsimore për mbrojtjen e fëmijës duke u bazuar në parimet bazë të Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijës dhe legjislacionin në fuqi, përfshirë edhe Ligjin për mbrojtjen e fëmijës.

Implementimi i kësaj politike nuk është vetëm një përgjegjësi e institucioneve dhe stafit arsimor, por një thirrje për përfshirjen aktive të të gjithë akterëve të shoqërisë.

Është momenti për të krijuar një kulturë ku vlerat e përbashkëta të edukimit dhe mbrojtjes së fëmijëve vendosen në qendër të qeverisjes arsimore, duke e bërë arsimin një mjedis ku secili fëmijë ndihet i sigurt dhe i respektuar.

Të gjithë kemi detyrë morale dhe profesionale që të kujdesemi dhe angazhohemi për edukimin dhe arsimimin cilësor të fëmijëve tanë, duke siguruar një ambient të shëndoshë e miqësor që mundëson mirëqenien optimale të fëmijëve dhe zhvillimin e potencialit të tyre të plotë. Ndaj zbatimi i kësaj politike është domosdoshmëri esenciale brenda fushëveprimit tonë dhe obligim i të gjithë neve.

Ta bashkojmë angazhimin e gjithsecilit për të ardhmen e shoqërisë tonë, fëmijët tanë!

Me respekt,

Arbërie Nagavci, Ministre e MASHTI



HYRJE

Mbrojtja e fëmijës është detyrë dhe përgjegjësi e të gjithë personave që punojnë apo vijnë në kontakt të drejtë apo të tërthortë me fëmijën. Këtu, në veçanti i referohemi punonjësve të institucioneve edukative, arsimore dhe aftësuese, publike dhe private, që interesin më të mirë të fëmijës duhet ta kenë parësor. Për t'i mbajtur të sigurtë fëmijët, përveç, punonjësve edukativ e arsimor, në kontekst të përfshirjes hyjnë edhe bashkëpunëtorët, partnerët, vullnetarët dhe praktikantët, dhe nga komuniteti: organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare apo personat juridik dhe të tjerëve - ofrues të shërbimeve për fëmijë.

Politika e mbrojtjes: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, është e mandatuar që të hartojë politika arsimore përfshirë *mbrojtjen e fëmijës*, politikë, kjo e cila është hartuar bazuar në parimet kryesore ndërkombëtare të mbrojtjes së fëmijës, dhe parashikon një varg rregullash për t'u zbatuar, për sigurinë dhe mirëqenien e fëmijës.

Politika për Mbrojtjen e Fëmijës është zotimi dhe përgjegjësia e institucionit për të garantuar dhe siguruar mbrojtjen e fëmijës, përmes dijes dhe punës profesionale, etikës së punës, aftësisë dhe shkathësive të personelit të institucionit arsimor, për të identifikuar dhe parandaluar rreziqet dhe dëmet, për të vlerësuar me kompetencë ngjarjet, si dhe

për të reaguar përshtatshëm me rrethanat e ngjarjes dhe fëmijën.

Kjo politikë bazohet në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Fëmijës (1989), Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionin për arsimin, legjislacionin për mbrojtjen e fëmijës, si dhe në praktikat dhe standardet më të mira ndërkombëtare dhe evropiane të mbrojtjes së fëmijës.

Qëllimi: Politika ka për qëllim krijimin e një mjedisi të sigurtë për të gjithë fëmijët në institucionet e arsimit parauniversitar publik dhe privat në Kosovë, duke vendosur parime dhe rregulla, të cilat duhet respektuar denjësisht. Kjo nënkupton edhe ndërlidhjen me shërbimet përkatëse sociale-ekonomike, shëndetësore, apo të drejtësisë, në rastet kur kjo tejkalon kompetencat e institucionit arsimor apo nuk mund të zgjidhet në kontekst të institucionit, për të parandaluar dhunën (në të gjitha format), abuzimin, neglizhimin apo çfarë do tjetër keqpërdorimi të fëmijës nga autoritetet, bashkëmoshatarët apo palët e treta, derisa ata ndodhen nën përkujdesjen e institucionit parauniversitar.

Politika e mbrojtjes, e fuqizon punën, përkushtimin, rregullin, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien brenda institucionit edukativ, arsimor dhe aftësues, si dhe në raport me autoritetet tjera.

Fushat e veprimit: Kjo politikë zbatohet në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar në Kosovë, duke përfshirë shkollat publike dhe private, institucionet parashkollore (kopshtet me bazë në komunitet, publiko-private dhe format tjera të organizimit parashkollor) dhe programet passhkollore, përfshirë këtu, por duke mos u kufizuar në qendrat mësimore dhe institucionet e qëndrimit ditor.

Udhëheqësi i Institucionit edukativ, arsimor dhe aftësues do të njoftojë punonjësit arsimorë, nxënësit, prindërit dhe të tjerët, në takimet e para për politikën për mbrojtjen e fëmijës dhe për personin përgjegjës, si dhe kontaktet e personit përgjegjës do të vendosen në vende të dukshme në hapësirat e institucionit arsimor. Politika e mbrojtjes do të jetë pjesë përbërëse e paketës së trajnimit orientues për secilin anëtar të ri të personelit dhe për personelin ekzistues, si pjesë e trajnimeve të rregullta.

Parimet kryesore që burojnë nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës, të përvetësuara edhe në legjislacionin vendor për mbrojtjen e fëmijës janë:

- Interesi më i mirë i fëmijës
- Mosdiskriminimi

- Mbijetesha dhe zhvillimi
- Pjesëmarrja

Parimet e përgjithshme të nxjerra nga legjislacioni i arsimit parauniversitar

Sa i përket Politikës së mbrojtjes në përputhshmëri me parimet e përgjithshme, institucionet edukative, arsimore dhe aftësuese duhet të sigurojnë se:

- Asnjë personi nuk guxon t'i mohohet e drejta për arsimim;
- Ofrohet pjesëmarrje dhe mundësi e barabartë për të gjithë fëmijët në edukim dhe arsim cilësor, mbrojtje dhe kujdes të nevojshëm për mirëqenien, sigurinë, shëndetin, duke krijuar ambient të favorshëm për zhvillimin brenda potencialit të plotë;
- Ministria, komuna, institucionet arsimore dhe aftësuese dhe komuniteti duhet ta bëjnë institucionin tërheqës dhe të sigurt për nxënësin, mësimdhënësin dhe prindërit, përmes përgjegjësisë të tyre përkatëse për kurrikulum, standardet e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave shkollore, shëndetësisë dhe sigurisë, ruajtjes së ambientit si dhe adresimit të çështjeve disiplinore dhe sjelljeve.

Përkufizimet:

Fëmijë - nënkupton çdo njeri nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet.

Fëmijë në nevojë për mbrojtje - është personi nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, pavarësisht fitimit të zotësisë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale, si dhe individ i nën moshën e përgjegjësisë penale, i cili dyshohet se ka kryer ose akuzohet se ka kryer veprë penale, si dhe fëmijët në konflikt me ligjin.

Dhunë ndaj fëmijës – nënkupton çdo veprim ose mosveprim me dashje, me anë të të cilit shkaktohet çdo lloj forme dhune fizike ose mendore, lëndimi ose abuzimi, lënia pas dore apo trajtimi neglizhent, keqtrajtimi ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual.

Dhunë fizike - nënkupton çdo formë të abuzimit fizik duke përfshirë këtu rrahjen me çfarëdo mjeti, goditje me shuplakë apo edhe me mjete të tjera, shtrëngimin e fytyrës dhe çdo veprim tjetër që shkakton dhimbje fizike.

Ndëshkim trupor – nënkupton çdo lloj ndëshkimi që përdor forcën fizike dhe që synon të shkaktojë dhimbje ose shqetësim të fëmijës, nga çdo person ligjërisht përgjegjës për fëmijën. Ndëshkimi trupor përfshin forma, të tilla, si: rrahje, tortura, shkundje, shtytje, djegie, goditje, pickim, çjerrje, kafshim, qortim i rreptë.

Dhunë psikologjike – nënkupton aktet të cilat shkaktojnë ose kanë mundësi të madhe të shkaktojnë dëm në shëndetin ose në zhvillimin

fizik, mendor, shpirtëror, moral ose social të fëmijës. Këto akte mund të jenë në kontrollin e prindit ose të një personi i cili ka përgjegjësi, është i besuar ose ka pushtet dhe përfshijnë kufizimin e lëvizjeve, talljen, denigrimin, fajësimin, kërcënimin, trembjen, diskriminimin, përqeshjen, ose forma të tjera jo fizike të armiqësisë ose të trajtimit refuzues.

Neglizhimi i fëmijës - nënkupton mosveprimin me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës;

Abuzim - nënkupton çdo veprim apo mosveprim, i qëllimshëm apo me paramendim, i kryer nga prindi, kujdestari, personi i besueshëm apo ndonjë person tjetër në pozitën e të besuarit, ose autoritetit që shkakton ose ka gjasa t'i shkaktojë dëm fizik, psikologjik, emocional apo social fëmijës;

Keqtrajtim - nënkupton të gjitha format e keqtrajtimit fizik dhe/ose emocional, abuzimin seksual, neglizhimin ose trajtimin neglizhues, apo shfrytëzimin tregtar, ose çdo shfrytëzim tjetër që çon në dëmtim real ose të mundshëm të shëndetit të fëmijës, të mbijetesës, zhvillimit ose dinjitetit në kontekstin e një marrëdhënieje përgjegjësie, besimi ose pushteti.

Prind - nënkupton personin/personat që e kanë lindur ose e kanë adoptuar fëmijën, të dy së bashku ose një i vetëm, të martuar ose të pamartuar, apo që kanë njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martese.

Përfaqësues ligjor - nënkupton prindin apo kujdestarin, i cili brenda përgjegjësi që i janë dhënë nga legjislacioni në fuqi ose nga gjykata, mbrojnë interesat e fëmijës nëpërmjet kryerjes apo jo të veprimeve juridike, në emër ose për llogari të fëmijës.

Kujdestar - është organ komunal profesional kompetent për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh që vepron në kuadër të Qendrës për Punë Sociale.

Person i besueshëm - nënkupton çdo person tjetër përveç prindit ose kujdestarit ligjor, i cili kujdeset për fëmijën, për shkak të një marrëdhënieje profesionale ose joprofesionale.

Përgjegjësi prindërore - nënkupton obligimin e prindit apo kujdestarit ligjor për sigurimin e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim sigurimin e mirëqenies emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur dhe mbajtur raporte vetanake me fëmijën dhe obligimin për t'i siguruar fëmijës mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë së fëmijës.

Mbrojtja e fëmijës - nënkupton parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës, keqtrajtimit, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, rrëmbimit, shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe punës së fëmijës në dhe jashtë shtetësisë.

Sistemi i mbrojtjes së fëmijës - nënkupton strukturën e caktuar formale dhe jo formale, me funksionet dhe kapacitetet e përmbledhura dhe të bashkuara për të parandaluar dhe reaguar dhunën, abuzimin, neglizhimin dhe shfrytëzimin e fëmijës.

Sistemi për mbrojtjen e fëmijës përbëhet nga këto komponente: resurset njerëzore dhe financiare, ligjet dhe politikat, qeverisja, monitorimi dhe mbledhja e të dhënave, shërbimet mbrojtëse dhe reaguese, si dhe menaxhimi i rastit. Sistemi përfshin edhe akterë të ndryshëm, siç janë: fëmijët, familja, komuniteti, shërbyesit dhe zyrtarët e nivelit qendror dhe lokal, duke mos përjashtuar edhe ata në nivel ndërkombëtar.

Profesionistë për mbrojtjen e fëmijës - nënkupton të gjithë personat, të cilët brenda mandatit të punës së tyre dhe në kontekstin e punës së tyre, janë në kontakt me fëmijën që ka nevojë për mbrojtje, ose kanë detyrë të përmbushin nevojat e fëmijës sipas këtij ligji apo ndonjë ligji tjetër në fuqi, standardi vendor apo ndërkombëtar.

Punonjësit edukativ- arsimor (edukatorët, mësimdhënësit) - janë shërbyes profesional publik që kryejnë detyra në institucionet edukative, arsimore dhe aftësuese sipas legjislacionit në fuqi.

Shërbimi pedagogjik/psikologjik - nënkupton profesionistët e fushave të punës të cilët kontribuojnë në përparimin e punës edukative-arsimore në institucionet parauniversitare.

Personeli profesional jomësimdhënës - personat e kualifikuar sipas standardeve të specifikuara në një akt nënligjor mund të zgjidhen nga komuna në institucionet arsimore për të ofruar shërbime profesionale, përfshirë: kujdesin mjekësor, mbështetjen pedagogjike-psikologjike, si dhe punën këshilluese dhe sociale.

INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE

Bazuar në parimet e përgjithshme të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, përgjegjëse për planifikimin, menaxhimin dhe zbatimin të sistemit të arsimit parauniversitar, janë Ministria, komunat, si dhe institucionet arsimore dhe ato aftësuese, në përputhshmëri me normat e miratuara ndërkombëtare për arsimin për të gjithë, të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen e grupeve të ndjeshme në shoqëri dhe për avancimin e barazisë gjinore.

I. PARANDALIMI

Për qëllimet e kësaj politike, parandalimi, nënkupton veprimet e parandalimit me bazë në institucion/shkollë, dhe ka të bëjë me vëmendjen, kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, në institucionin arsimor. Poashtu, kjo nënkupton, vendosjen e procedurave të përshtatshme për t'u ndjekur nga punonjësit edukativ e arsimor, në mënyrë që të parandalohet shfaqja e ndonjë rreziku apo dëmi për fëmijën.

Në kuadër të aktiviteteve parandaluese, bashkëpunimi apo puna e përbashkët e udhëheqësve të institucionit me mësimdhënësit, me shërbimet pedagogjike dhe psikologjike, shërbimet e tjera sociale dhe shëndetësore, organizatat joqeveritare, organizatat ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve,

personat juridikë që ofrojnë shërbime për fëmijët, praktikantët dhe vullnetarët, komuniteti dhe të tjerët të përfshirë drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë në mbrojtjen e fëmijëve është shumë i rëndësishëm dhe çdoherë planifikohet .

Aktivitetet parandaluese me bazë në institucion/shkollë jetësohen, përmes aktiviteteve të rregullta kurrikulare (dhe jokurrikulare), punonjësve të rekrutuar sipas meritës, plotësimin e strukturës së të punësuarve me shërbime profesionale pedagogjike dhe psikologjike, këshilltarë të punës sociale dhe mjekë të shkollës/personel profesional, trajnimit të përshtatshëm të mësimdhënësve, rregulla të sjelljes/etikës, monitorim dhe vlerësim, dhe të ngjashme të cilat bëhen në bashkëpunim me komunat dhe MASHTI-n.

⇒ Kurrikula

Sa i përket Kurrikulës, duhet bërë:

- Trajtimi i temave/çështjeve që ndërlidhen me mbrojtjen e fëmijëve, përmes kurrikulës;
- Zhvillimi i aktiviteteve jashtëkurrikulare (aktivitete të interguara, lojë, aktivitete sportive, artistike, fushata, bashkëpunime me shërbime sociale, të drejtësisë, të organizatave joqeveritare dhe ngjashëm);
- Zhvillimi dhe përdorimi i materialeve informuese dhe vetëdijësuese përgjatë procesit mësimor.

⇒ Rekrutimi dhe punësimi

EDUKATORËT/MËSIMDHËNËSIT:

Punonjësit edukativë e arsimorë që ushtrojnë procesin e edukimit dhe arsimimit janë shtyllat kryesore e sistemit të arsimit dhe mirëqenies së fëmijës. Për këtë arsye, është esenciale që institucionet e arsimit parauniversitar të sigurojnë që stafi edukativ e arsimor, por edhe personeli tjetër mbështetës, të jenë zgjedhur me kujdes, për të ushtruar përgjegjësitë dhe kompetencat e tyre në raport me fëmijët. Në kontekst tjetër të punës dhe punësimit, kjo zbatohet edhe për praktikantët, kontraktorët, vullnetarët partnerët dhe të tjerë të përfshirë në forma të ndryshme, të cilët bashkëpunojnë për të krijuar një mjedis të sigurtë në shkollë.

Në këtë kontekst, gjatë rekrutimit kërkohen dhe verifikohen/shqyrtohen, edhe:

- referencat,
- historiku,
- gjendja penale,
- kualifikimet dhe kompetencat.

Pas fazës së rekrutimit, institucioni arsimor sigurohet se përgjegjësitë dhe kompetencat ushtrohen nga punonjësi arsimor i zgjedhur, sipas kriterëve dhe bazuar në:

- Përkushtimin ndaj profesionit;
- Përkushtimin ndaj nxënësit/fëmijës;

- Përkushtimin ndaj institucionit edukativ, arsimor dhe aftësues.

BASHKËPUNËTORËT PROFESIONALË

Bazuar në udhëzimin administrativ të MASHTI, për funksionimin e shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkollë, pedagogu dhe psikologu marrin pjesë në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me planifikimin dhe realizimin e punës së gjithmbarshme në shkollë, si: planifikimin e programit të punës mësimore, hulumtim, monitorim, analizë e vlerësim të të gjithë akterëve në shkollë, realizim efektiv të procesit edukativ-arsimor, punë me nxënës, mësimdhënës, prindër, komunitet dhe institucione, organizata qeveritare dhe joqeveritare, zhvillim profesional të stafit të shkollës, zhvillim personal, në zhvillim të projekteve, etj.

PEDAGOGU

- Kontribuon në realizimin edhe përparimin e punës edukative-arsimore në institucione të arsimit parauniversitar, në harmoni me ligjet dhe dokumentet pedagogjike të MASHTI-t si Korniza e Kurrikulit të Kosovës, Kornizat Bërthamë dhe dokumente tjera relevante;
- Kontribuon në lehtësimin e trajtimit të problemeve të ndryshme që shfaqen në institucion/shkollë si tek fëmijët,

nxënësit, mësimdhënësit, prindërit apo të gjithë akterët jashtë shkollës si dhe kontribuon në ngritjen e cilësisë së veprimtarisë edukative-arsimore.

- Bashkëpunon me prindër;
- Bashkëpunon me nxënësit;
- Ndhmon bashkëveprimin midis mësimdhënësve;
- Bashkëpunon me institucione profesionale dhe komunitetin;
- Kontribuon në zhvillimin profesional;
- Bashkëpunon me psikologun.

PSIKOLOGU

- Psikologu kontribuon në lehtësimin e procesit të të nxënësve dhe promovon zhvillimin kognitiv, emocional, social dhe personal të nxënësve;
- Psikologu ofron ndihmë në tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjithë akterët në shkollë.

PERSONI PËRGJEGJËS/PIKA E KONTAKTIT

Institucionet e arsimit parauniversitar e caktojnë nga një person përgjegjës (nga personeli i institucionit arsimor/shkollës, siç është, psikologu, pedagogu apo administratori i shkollës) për mbrojtjen e fëmijëve, i cili është përgjegjës për promovimin e mbrojtjes së fëmijëve. Në

mungesë të shërbimit përkatës të psikologut apo pedagogut, përgjegjësia kalon tek edukatori, mësimdhënësi apo arsimtari (personi përgjegjës apo pika e kontaktit), që caktohet nga udhëheqësia e institucionit arsimor. Institucioni sigurohet që të gjithë punonjësit edukativë e arsimorë përgjegjës të jetë profesionistë të fushës dhe të trajnuar përshtatshëm.

Personi përgjegjës, në rolin e pikës së kontaktit do të kryejë këto detyra:

- Orienton/udhëzon lidhur me zbatimin e politikës, procedurave për mbrojtjen e fëmijës dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me mbrojtjen e fëmijës;
- Ofron trajnime dhe mbështetje për personelin tjetër, përfshirë vullnetarët dhe prindërit/kujdestarët brenda institucionit ku vepron;
- Reagon për rastet e shkeljes së politikës së mbrojtjes së fëmijës;
- Informon fëmijët në gjuhë të kuptueshme, lexueshme dhe të thjeshtë për rregullat e politikës, e veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Kërkon informacione mbi shqetësimet eventuale të fëmijës;
- Bashkëpunon me prindërit, kujdestarët apo përfqësuesit ligjorë të fëmijës;
- Shpjegon sjelljet dhe ndryshimin e sjelljeve të fëmijës në shkollë;
- Ndhmon identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që i kanosen fëmijës/fëmijëve;

- Reagon menjëherë (apo brenda kohës së arsyeshme) ndaj shqetësimeve të fëmijës: dhunës/abuzimit dhe neglizhimit,
- Mban shënime për rastet dhe veprimet e ndërmarra,
- Siguron që institucioni raporton në SMIA;
- Raporton sipas vlerësimit profesional tek autoritetet përkatëse;
- Monitoron dhe përcjell rastet e referuara;
- Promovon vetëdijësimin dhe zbatimin e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës;
- Monitoron dhe raporton për zbatimin e politikës së mbrojtjes.

Personi përgjegjës, pritet që, midis tjerash:

- Të ketë njohuri/përvojë rreth punës me fëmijë;
- Të ketë njohuri/përvojë për çështjet e dhunës/abuzimit ndaj fëmijës;
- Të ketë njohuri/përvojë mënyrat e parandalimit të dhunës;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi, veçanërisht me fëmijët;
- Të ketë shkathtësi për trajnime dhe prezantime.

Personi përgjegjës i caktuar si pikë kontakti për mbrojtjen e fëmijëve, nuk është dhe nuk duhet të jetë personi i vetëm përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve në institucionin arsimor, dhe përderisa mbrojtja e fëmijëve është përgjegjësi ligjore e të gjithë personave të përfshirë në bashkëveprimin me fëmijë, përgjegjës

kryesor për zbatimin e politikës për mbrojtjen e fëmijës, është Drejtori i institucionit edukativ, arsimor e aftësues, publik dhe privat.

Informimi, vetëdijësimi dhe trajnimi

Punonjësit në institucionet edukativo-arsimore, udhëzohen për përmbajtjen e Politikës për mbrojtjen e fëmijës dhe pjesën e programeve për ngritjen e kapaciteteve nga fusha e mbrojtjes së fëmijëve, nëpërmjet takimeve të rregullta me shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, sesionet informuese, trajnimet, seminarët dhe forma tjera të organizimit.

Udhëheqja e institucionit/shkollës dhe kuadri përgjegjës (siç është, psikologu/pedagogu, edukatori, mësimdhënësi, koordinatori i cilësisë, këshilltari i karrierës, social, mjeku, etj.), në bashkëpunim me ofrues të akredituar të trajnimit nga fusha e mbrojtjes së fëmijës, duhet të sigurojnë organizimin e trajnimeve dhe ofrimin e mbështetjes së vazhdueshme për të gjithë punonjësit arsimor dhe pjesëtarët e tjerë të cilët janë në kontakt direkt apo indirekt me fëmijën, për të siguruar që ata kanë njohuritë dhe kompetencat e nevojshme.

Trajnimet që do të ofrohen për punonjësit edukativ, arsimor e aftësues, përfshijnë:

- Trajnimi orientues: në fillimin e periudhës së punës në institucionin edukativ, arsimor dhe aftësues, të

gjithë do të informohen për Politikën e mbrojtjes së fëmijës;

- Trajnimi i obliguar: institucioni edukativo-arsimor do të organizojë së paku një (1) trajnim në vit nga fusha e mbrojtjes së fëmijës për të gjithë punonjësit.

Trajnimet e mbajtura duhet të shënohen dhe mbahen në dosjet e institucionit.

Rregullat e brendshme

Të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar duhet të caktojnë rregullat e tyre të shkruara për të gjithë personelin, por duke mos u kufizuar tek prindërit/kujdestarët ligjor, vullnetarët e bashkëpunëtorët e institucionit, dhe të tjerë të përfshirë në institucionin arsimor dhe punën me fëmijë. Rregullat e institucionit duhet të përfshijnë pritshmëritë për sjelljen e duhur gjatë punës me fëmijë, procedurat e raportimit për shqetësimet e dhunës/abuzimit dhe neglizhencës së fëmijëve dhe për pasojat e shkeljes gjatë kryerjes së detyrës.

Rregullat duhet të specifikojnë:

- Trajnimet minimale të domosdoshme për punën me fëmijë;
- Përfshirjen e vlerave dhe parimeve kryesore të mbrojtjes së fëmijës në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijët;
- Standardet e larta të sjelljes personale dhe profesionale;

- Përfshirjen e fëmijeve në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën dhe për fëmijën;
- Përfshirjen e prindërve në çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët (e posaçërisht fëmijët e tyre);
- Trajtimin e të gjithë fëmijëve në mënyrë të barabartë dhe sipas parimeve të politikës së mbrojtjes së fëmijës;
- Sigurimin e një mjedisi të përshtatshëm për moshën dhe zhvillimin psiko-fizik të fëmijës;
- Mbikëqyrjen dhe mbrojtjen kompetente të fëmijëve gjatë kohës që ata janë në institucion (ardhjes, qëndrimit, ushtrimit, pushimit dhe shkuarjes);
- Kërkesat për mbikëqyrje dhe mbrojtje kompetente të fëmijës gjatë gjithë kohës që ata janë jashtë institucionit arsimor (vizita, pikniqe, transport, etj), por nën përgjegjësinë e institucionit;
- Sjelljen e fëmijëve gjatë qëndrimit në institucion, lojës, aktiviteteve, ecjes në rresht, kohës së ushqimit, proceseve fiziologjike dhe të ngjashme me rëndësi për shmangien e disa prej rreziqeve që mund të parandalohen;
- Sjelljen e personelit dhe komunikimit (miqësor) me fëmijën (përdorimin e gjuhës së kuptueshme, të qartë dhe jogjyquese, dëgjimin aktiv, etj), sipas moshës dhe fazës së zhvillimit të fëmijës;

- Kujdesin dhe masat për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e fëmijës, dhe të tjerëve të përfshirë në mbrojtjen e fëmijës;
- Kërkesat për veshjen e përshtatshme në institucion, dhe për të gjithë që gravitojnë institucionet para-universitare, në përputhshmëri me Rregulloren për Kodin e veshjes në institucionet e Republikës së Kosovës;
- Nxitjen e sjelljeve të mira, tek fëmijët përmes komunikimit dhe bashkëveprimit profesional (përmes leximit të përbashkët, ofrimi i shembujve nga praktikat e mira, etj),
- Vetëdijësimi i fëmijëve për format e dhunës/abuzimit, e në veçanti vetëdijësimi i fëmijëve me nevoja të veçanta;
- Informimin/këshillimin e fëmijëve për mekanizmat e mbrojtjes nga dhuna dhe abuzimi;
- Bashkëpunimin me prindër, personelin e Institucionit edukativ, arsimor dhe aftësues, si dhe institucionet përkatëse sipas nevojës;
- Përfshirjen e prindërve sipas profileve të tyre profesionale, duke kontribuar në fusha të ndryshme për edukimin, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës;
- Ruajtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së fëmijës dhe familjes.

Sjelljet e papranueshme janë:

- Diskriminimi, turpërimi, poshtërimi dhe degradimi i fëmijës;
- Sjelljet abuzive, neglizhente dhe të dhunës (verbale, psikologjike, fizike, seksuale);
- Qëndrimi në ambient të mbyllur vetëm me (një) fëmijë;
- Publikimi pa autorizim i çfarëdo fotografie të fëmijës;
- Ekspozimi i fëmijës në situata jo të denja.

Komunikimi me media: Institucioni edukativ, arsimor dhe aftësues bën edhe edukim medial, gjersa sigurohet që të merren të gjitha masat për mbrojtjen e fëmijës, përfshirë keqpërdorimin për qëllime komerciale, atëherë kur fëmija paraqitet në media në kuadër të aktiviteteve të institucionit.

Institucioni kujdeset për informimin dhe vetëdijësimin e fëmijëve, prindërve dhe stafit profesional dhe mbështetës për përdorimin e sigurt, të dobishëm e të përgjegjshëm të mediave, dhe në asnjë rast, pa lejen e prindit apo kujdestarit ligjor nuk e ekspozon fëmijën përmes fotografisë, videove, rrjeteve sociale apo në aktivitete mediale, përveç kur ato bëhen për qëllime edukative-arsimore.

II. REAGIMI

IDENTIFIKIMI: Personeli i institucionit duhet të jetë shumë i kujdesshëm për tërë procesin, nga identifikimi deri te reagimi (referimi/raportimi) ndaj shqetësimeve

që kanë të bëjnë me fëmijët. Identifikimi i rasteve të fëmijëve/ nxënësve dhe të tjerëve brenda institucionit/shkollës, që mund të jenë viktimë të dhunës (apo kryes/viktimë), shfrytëzimit, keqtrajtimit, abuzimit apo neglizhimit në mjedise të ndryshme, është veprim shumë i ndjeshëm dhe hapi i parë në procesin e ndërhyrjes dhe mbrojtjes. Përgjatë identifikimit dhe trajtimit duhet pasur kujdes që femiu mos të bie pre e etiketimit (stigmatizimit), lëndueshmërisë dhe riviktimizimit.

Shenjat dalluese që tregojnë se fëmija mund të ketë përjetuar dhunë apo abuzuar:

- Shenja të dukshme të goditjes/dhunës fizike (njolla/gërvishje/hematoma);
- Mungesat, vonesat e paarsyeshme në mësim dhe braktisja;
- Mungesa e përqendrimit/rënia e interesit për aktivitete/ mësim;
- Vështirësi në të nxënë, kuptuar, mësuar;
- Ndryshimet në sjellje, qëndrime;
- Sjellje antishoqërore;
- Mospranimi për bashkëveprim social;
- Shenja ankthi, frike, stresi;
- Humbja e peshës;
- Shenja të tërheqjes dhe të izolimit;
- Shfaqja e sjelljeve agresive;
- Vetëvlerësim i ulët.

Shënim: në përmbledhje këto janë disa nga shenjat e mundshme dhe të supozuara për identifikimin e fëmijës, por jo domosdoshmërisht të gjithë ata (fëmijë/

nxënës) që i kanë këto shenja kanë të bëjnë me dhunë/abuzim apo tjetër, për shkak se jo në të gjitha rastet këto shenja tregojnë dhunë dhe mund të jenë shkaktuar nga arsye tjera, si aksidente dhe sëmundje, prandaj nuk duhet nxituar me supozime.

Çdo herë, kur dyshohet për raste të tilla, personeli i institucionit edukativ, arsimor dhe aftësues, duhet të ndërmarrë veprime të përshtatshme, në përputhshmëri me rregullat dhe rrethanat. Në të gjitha rastet e tjera, kur ekziston dyshimi i bazuar për çfarëdo rasti dhune, abuzimi, neglizhimi që e tejkalon mandatin dhe kompetencat e institucionit edukativo-arsimor, rasti duhet referuar në institucionet përkatëse në bashkëpunim me autoritetet, si për shembull: shërbimet shëndetësore, shërbimet sociale të Qendrës për Punë Sociale, Policisë, përkatësisht institucionet për mbrojtjen ligjore të fëmijëve.

RAPORTIMI/REFERIMI: Të gjitha veprimet që ndërmerren nga institucioni arsimor, interesin më të mirë të fëmijës duhet ta kenë konsideratën kryesore. Institucionet e arsimit parauniversitar duhet të zbatojnë procedura të qarta të raportimit për shqetësimet e ngritura të abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve, duke siguruar që rastet raportohen, përshtatshmërisht sipas dispozitave ligjore në fuqi, përfshirë Protokollin për parandalim dhe referim të dhunës në IAP.

Raportimet për shqetësimet mund të vijnë nga një sërë burimesh, duke përfshirë personelin e institucionit, vullnetarët,

partnerët, fëmijët dhe anëtarët e familjeve/komunitetit.

Në të gjitha rastet kur dyshohet apo raportohet për ushtrimin e dhunës dhe abuzimit, ngacmimit seksual, neglizhencës së fëmijëve, dhe vihet në dijeni insitucioni edukativ, arsimor dhe aftësues, këto informata duhet të merren seriozisht dhe të veprohet, bazuar në rrethanat.

Krahas kësaj, pas shqyrtimit të plotë të fakteve, vendoset nëse rasti duhet raportuar tek institucionet tjera si, shërbimet sociale apo policore, në pajtueshmëri të plotë me Ligjin për mbrojtjen e fëmijës dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Bazuar në Protokollin për Parandalim dhe Referim të Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar, institucionet duhet që në një hapësirë të dukshme ta vendosin diagramin për sistemin e raportimit dhe referimit, ashtu që komuniteti i institucionit të familjarizohet me procedurat dhe shërbimet ndërinsitucionale (të zhvilluar nga MASHTI).

MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE PRIVATËSISË: I gjithë stafi udhëheqës, edukativ-arsimor, mbështetës, administrativ, teknik, vullnetarët, prindërit/kujdestarët, partnerët e institucionit duhet të mbrojnë dhe ruajnë konfidencialitetin e informatave në lidhje me rastet e raportuara, sipas detyrimeve që rrjedhin nga Ligji për mbrojtjen e

fëmijës dhe Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë.

Kur ngrihen shqetësime apo bëhen raportime, i duhet kushtuar rëndësi të veçantë konfidencialitetit, mbrojtjen e privatësisë për referuesin ashtu dhe për fëmijën (ët)/të rriturit e përfshirë.

Informacioni duhet të ndahet vetëm brenda procedurave të raportimit, trajtimit dhe referimit, pa cënuar identitetin dhe dinjitetin e fëmijës.

BASHKEPUNIMI NDERINSTITUCIONAL; Duke qenë se shërbimet në rastet e mbrojtjes janë të integruara, multidisiplinare, kërkohet bashkërendim ndërinstitutional në ofrimin e shërbime në përputhje në nevojat e fëmijëve, për edukimin dhe zhvillimin e tyre brenda potencialit të plotë

III. MONITORIMI DHE LLOGARIDHENIA

Ministria, komunat dhe Institucioni edukativo, arsimor dhe aftësues do të monitorojnë rregullisht zbatimin e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijës. Progresi, performanca dhe mësimet e nxjerra në nivel institucioni raportohen çdo vit nga personi përgjegjës si pikë kontakti për mbrojtjen e fëmijëve, te udhëheqja dhe personeli. Ky raportim përfshihet në raportet vjetore të institucionit.

Shkelja e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve mund të çojë në pezullim apo ndërprerje të çfarëdo lloji të angazhimit në institucionin edukativ, arsimor dhe aftësues. Në çdo fazë të mbikëqyrjes së

punës, kërkimit të përgjigjesisë dhe llogaridhënies, përfshirë dhe hetimin e shkeljeve, respektohen kushtet dhe legjislacioni në fuqi i punës, duke ruajtur privatësinë dhe konfidencialitetin e personave të përfshirë.

Vendimet rreth shkeljeve të politikës për mbrojtjen e fëmijëve nuk merren vetëm nga punonjësi i institucionit, por bazuar në monitorimin e rregullt, analizën e rastit dhe legjislacionin e aplikueshëm.

LEGJISLACIONI:

1. Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (1989),
2. Ligji Nr. 04/L-032, Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës,
3. Ligji Nr. 06/L-084 Për Mbrojtjen e Fëmijës,

4. Ligji Nr. 06/L-082 Për Mbrojtjen e të dhënave personale,
5. Ligji Nr.04/081, Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.02/L-17 për shërbimet Sociale dhe Familajre,
6. Ligji Nr. 08/L-153 Për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme
7. Udhëzim Administrativ MASHT Nr. 34/2014 Funksionimi i Shërbimit Pedagogjik – Psikologjik në Shkolla,
8. Udhëzim Administrativ Nr. 25/2014, Licencimi i Mësimdhënësve

RISHIKIMI: Kjo politikë do të rishikohet dhe përditësohet sipas nevojës dhe rrethanave, ndryshimeve në kornizën ligjore dhe zhvillimeve tjera, për t'v adresuar sa më mirë nevojat e mbrojtjes së fëmijës.

(Kjo politikë u hartua nga MASHT, me përfaqësim ndërinstitutionale dhe me përkrahje nga Save the children, Terre des Homes, Syri i Vizionit dhe KOMF)



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/

*Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science, Technology
and Innovation*

DEKLARATË E ZOTIMIT¹

Unë _____, me numër personal _____, deklaroj se e kam lexuar dhe kuptuar politikën për mbrojtjen e fëmijëve, e njoh si vlerë dhe përgjegjësi individuale dhe zotohem për zbatimin e kësaj politike sipas interesit më të mirë të fëmijës, për edukim, arsimim dhe zhvillim!

Emri Mbiemri:

Vendi: _____

Pozita, institucioni: _____

Data: _____

Nënshkrimi: _____

¹¹ (Deklarat nënshkruhet nga çdo i punësuar dhe i angazhuar në institucion edukativ, arsimor dhe aftësues)

